



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



Zyra Rregullatore për Ujësjiellës dhe Kanalizim

10 vite të Rregullimit të **KRU**



10 VITE TË RREGULLIMIT TË KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT

Me rastin e 10 vjetorit të themelimit, Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim publikon këtë Broshurë përmes së cilës lexuesit i ofrohet njohuri bazë për historikun, rolin dhe përgjegjësitë e rregullatorit, sa i përket sektorit të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë, me theks të veçantë në rregullativën ekonomike

Në mënyrë informative në këtë broshurë janë elaboruar çështjet si në vijim:

- Themelimi, roli, përgjegjësitë, të arriturat, si dhe synimet për të ardhmën nga Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim;
- Reforma e sektorit të shërbimeve të ujit të ndodhura gjatë viteve 2003-2008: Konsolidimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve publike të ujit, Korniza rregulluese dhe procesi i Korporatizimit;
- Roli dhe përgjegjësitë institucionale në sektorin e ujit, baza e tyre ligjore, si dhe
- Të arriturat në performancën aktuale të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit dhe sfidat e tyre kryesore.

Kjo broshurë mund të ju shërbejë zyrtarëve të institucioneve përgjegjëse të këtij sektori, si dhe të gjithë atyre personave të cilët, janë të lidhur apo kanë interes në sektorin e ujit në Kosovë.

KUSH ËSHTË ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM (ZRRUK)

ZRRUK është themeluar si organ i pavarur në bazë të Kornizës Kushtetuese me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 më 26 nëntor 2004. Sipas kësaj Rregulloreje, ZRRUK ka qenë përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve të ndërmarrjeve publike dhe shoqërore që ofrojnë shërbime të ujit, kanalizimit, mbeturinave të ngurta dhe furnizuesve të ujit më shumicë në Kosovë. Në vitin 2008 kompetencat janë bartë nga Përfaqësuesi Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nga viti 2008, ZRRUK është i mandatuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (të cilit njëkohësisht edhe i raporton), në bazë të ligjit Nr.03/L-086, përgjegjës për të siguruar se Ndërmarrjet Publike të cilat ofrojnë shërbime të ujit në Kosovë tu ofrojnë konsumatorëve shërbime efikase dhe cilësore me çmim të arsyeshëm dhe korrekt.

Si rregullator ekonomik, qëllimi primar i ZRRUK është të shoh se ofruesit e shërbimeve të rregulluara, nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopole duke siguruar që ata ofrojnë shërbime me standarde të mira, me çmime të arsyeshme dhe se të drejtat dhe obligimet e tyre, si dhe të konsumatorëve të tyre balanohen dhe implementohen mirë.

Rregullimi ekonomik i sektorit të ujit nga një rregullator i pavarur është në pajtim me praktika të mira, të dëshmuara si të suksesshme në disa vende Evropiane dhe pasqyron këto karakteristika kryesore të këtij sektori:

- ✓ rajonale, d.m.th. bazohet në pellgjet e lumenjëve, shpërndarjen e resurseve të ujit,
- ✓ monopol natyror,
- ✓ mundësi të konsiderueshme për përmirësime me anë të ekonomisë së shkallës,
- ✓ nevojë për investime afatgjata dhe menaxhim të mirë të sektorit,
- ✓ disponueshmëria e kufizuar me resurse të afta teknike dhe menaxheriale.

CILI ËSHTË ROLI I ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUK-ut, janë:

- ✓ **Përcaktimi i tarifave** që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve,
- ✓ **Dhënia e Licencave** për ofruesit e shërbimeve të ujit,
- ✓ **Monitorimi dhe raportimi i performansës** së ofruesve të shërbimeve,
- ✓ **Mbrojtja e interesave të konsumatorëve** duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopolistike dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit,
- ✓ **Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve** dhe përkrahja e tyre,
- ✓ **Nxitja e konkurrencës** në sektorët e ujit përmes krahasimit të performansës (“benchmarking”),



Duke u bazuar në *Vizionin* dhe *Misionin e saj*, ZRRUK i ka parashtruar vetes disa objektiva specifike:

- ✓ Përcaktimi i tarifave të balancuara që pasqyrojnë shpenzimet për shërbimet e ujit dhe që mundësojnë qëndrueshmëri financiare të ofruesve të shërbimeve, duke pasur parasysh mundësitë e konsumatorëve për të paguar,
- ✓ Nxitja e konkurrencës në sektorin e ujit dhe duke përdorur krahasime (“benchmarking”), kudo që është e mundur për të vlerësuar dhe stimuluar përmirësimin e performansës së ofruesve të shërbimeve të ujit,
- ✓ Mbrojtja e interesave të konsumatorëve duke siguruar që shërbimet që iu ofrohen atyre janë në pajtim me standardet komerciale dhe teknike të përcaktuara në rregullat e ZRRUK-ut,
- ✓ Qëndrueshmëria financiare e ZRRUK, me legjitimitet dhe pavarësi të plotë dhe të qartë, që iu përgjigjet institucioneve të Kosovës.



JO PËRGJEGJESITË E ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM

Në përputhje me praktikat e mira të rregullimit, qasja rregullatore e ZRRUK është e drejtuar në rezultate. ZRRUK para së gjithash merret me nivelin e shërbimeve dhe koston e përgjithshme. Pra,

- ✓ ZRRUK, nuk ndërhyr në mënyrë të drejtpërdrejt në menaxhimin e ditor të ofruesve të shërbimeve që i rregullon, duke ia lënë këtë përgjegjësi menaxhmentit të tyre dhe institucioneve mbikëqyrëse.
- ✓ ZRRUK, nuk është përgjegjës për vendosjen e standardeve të cilësisë së ujit të pijshëm ose për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Kjo është përgjegjësi e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, (IKSHP). Megjithatë ne punojmë për së afërmi me IKSHP, për të siguruar se uji i distribuuar nga Kompanitë e rregulluara është i pijshëm dhe cilësor për konsum nga qytetarët.
- ✓ ZRRUK nuk është përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit. Kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Megjithatë qasja jonë është për të siguruar që politikat dhe procedurat tona nuk dëmtojnë mjedisin dhe shëndetin publik.



ROLI DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE NË SEKTORIN E UJIT

Sektori i ujërave në Kosovë, parimisht përbëhet nga 2 nën sektorë:

- (i) **Sektorin e resurseve ujore**, Autoritetet përgjegjës për menaxhimin e resurseve ujore si dhe për hartimin e politikave dhe strategjisë për administrimin e ujërave në Kosovë, është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
- (ii) **Sektorin e shërbimeve të ujit**. Sektori i shërbimeve të ujit (ujësjellësi dhe kanalizimi) ndërkaq përfshinë shërbimet e furnizimit me ujë, si dhe shërbimet e kanalizimit të cilat ofrohen nga kompanitë publike regjionale të ujit të licencuara dhe të rregulluara nga ZRRUK



Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

MZHE në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (nr. 03/L-087) përmes Njësisë për Politika dhe Monitorim mbikqyrë afarizmin e ndërmarrjeve publike të cilat janë pronësi e Republikës së Kosovës, si dhe përkujdeset për operimin e përgjegjshëm dhe transparent të tyre.

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK)

ZRRUK është themeluar me Ligjin për Rregullimin e Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit (nr. 03/L-086) i cili përcakton kornizën ligjore për rregullimin ekonomik të kompanive publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit në Kosovë, si dhe përcakton përgjegjësitë dhe autorizimet e ZRRUK si rregullator i pavarur që i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH)

MMPH është përgjegjëse për hartimin e politikave për sektorin e ujërave, si dhe për hartimin e planit strategjik për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë. Poashtu sipas këtij ligji MMPH është autoritet kompetent për lëshimin e lejeve për shfrytëzimin e ujërave, si dhe për shkarkimin e ujërave të zeza.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publike të Kosovës (IKSHPK)

IKSHPK është autoritet përgjegjës për përcaktimin e standardeve të cilat duhet t'i plotësojë uji i pijes që distribuohet nga ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe poashtu monitoron zbatimin e këtyre standardeve. Baza ligjore për autoritetin dhe përgjegjësitë e IKSHPK mbështet në Udhëzimin Administrativ (nr. 16/2012) për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu, me të cilin rregullohet problematika e cilësisë së ujit të pijes.

Komunat

Sipas Ligjit për Vetqeverisjen Lokale në Kosovë (nr. 03/L-040), komunat janë kompetente për ofrimin e shërbimeve publike të furnizimit me ujë dhe të mbeturinave. Kjo kompetencë e tyre në rastin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit duhet të realizohet përmes Marrëveshjeve të Shërbimit që nënshkruajnë komunat me kompanitë përkatëse regjionale që ofrojnë shërbimet e veta në komunën respektive.

Këshilli Ndërmintor për Ujëra (KNMU)

Në bazë të Ligjit për Ujërat e Kosovës, Nr. 04/L-147, (KNMU) është trup koordinues dhe vendim-marrës që shqyrton çështjet sistemore të ujërave, që merret me harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e rezervave të ujit dhe sistemit të Kosovës. KNMU u themelua me Vendim të Qeverisë së Kosovës, dhe përbëhet nga Ministri e Zhvillimit Ekonomik, Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministres për Integritet Evropian (katër ministritë e linjës) duke siguruar koordinimin e përgjithshëm të zhvillimit të sektorit të ujit në vend.

REFORMA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT

Në Kosovë, në vitin 2003 ka filluar reformimi i sektorit të ujit që kryesisht ka kaluar në tri faza:

Faza e parë, fillimisht ka përfshirë procesin e ristrukturimit (konsolidimit) të ndërmarrjeve publike komunale të ujit. Me këtë proces, i cili është finalizuar në fund të vitit 2006, nga 35 ndërmarrje komunale (shumica prej të cilave kanë ofruar praktikisht të gjitha shërbimet komunale) janë krijuar 7 ndërmarrje publike regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Motivi kryesor për regjionalizimin e ndërmarrjeve komunale ka qenë krijimi i ndërmarrjeve të qëndrueshme financiarisht përmes:

- ✓ Shfrytëzimit të potencialit që ofron ekonomia e shkallës,
- ✓ Zbatimit efektiv të mbikqyrjes rregullatore dhe menaxheriale,
- ✓ Përgatitjes për reformim të mëtejshëm me Partecipimin e Sektorit Privat (PSP),
- ✓ Parandalimit të ndërhyrjes politike në menaxhmentin e ndërmarrjeve publike.

Procesi i konsolidimit është përmbyllur në fund të vitit 2006. Efektet pozitive të këtij procesi janë evidente, dhe ato kryesisht konsistojnë në: eliminimin e strukturës së fragmentarizuar, ngritjen e llogaridhënies dhe transparencës, dhe ngritjen e efikasitetit dhe performancës.

Faza e dytë e reformave ka qenë krijimi i kornizës ligjore për rregullimin ekonomik të ndërmarrjeve publike të ujit dhe mbeturinave, në nëntor të vitit 2004 (përmes Rregullores 2004/49) dhe themelimi i Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) si autoritetet përgjegjëse për rregullimin ekonomik të ndërmarrjeve publike të ujit dhe mbeturinave.

Faza e tretë e reformave ka konsistuar në korporatizimin e ndërmarrjeve publike të ujit dhe mbeturinave, proces ky i përfunduar në vitin 2007, përmes të cilit këto kompani janë shndërruar në korporata (procesi i korporatizimit) që si rezultat ka pasur transformimin e ndërmarrjeve publike në shoqëri aksionare (Sh. A.) të cilat kanë një identitet të qartë ligjor dhe financiar dhe të cilat administrohen sipas parimeve të qeverisjes korporative. Çështja e pronësisë së këtyre ndërmarrjeve është rregulluar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike (i miratuar me 13 qershor 2008).

OFUESIT E SHERBIMEVE TË UJESJELLESIT DHE TË KANALIZIMIT

Në pajtim me kornizën ligjore, ZRRUK ka licencuar 8 kompani publike prej të cilave:

(i) 7- ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe analizimit,

1. **KRU 'Prishtina' Sh. A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliqi, Podujevë, Lipjan, Shtimje, Graçanic dhe Drenas;
2. **KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë, dhe Dragash;
3. **KRU 'Hidrodrini' Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan;
4. **KRU 'Mitrovica' Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtri;
5. **KRU 'Hidrosistemi Radoniqi' Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë dhe Rahovec;
6. **KRU 'Hidromorava' Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë dhe Viti;
7. **KRU 'Bifurkacioni' Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Ferizaj dhe Kaçanik .

(ii) 1- ofron shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë të papërpunuar për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza është:

1. **NPH 'Tbër-Lepenci' Sh.A.**



TË ARRITURAT E ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM

Në parim, të arriturat e ZRRUK derimë tani në pika të shkurtëra munde të pëmbliohen:

- Përgatitjen dhe nxjerrjen e instrumenteve ligjore, primare dhe sekondare,
- Licencimin e ofruesëve të shërbimeve të ujit,
- Miratimi i tarifave për ujë,
- Zhvillimi i metodologjisë për përcaktimin e tarifave dhe hartimi i politikave tarifore,
- Përpilimi i udhëzimeve të kontabilitetit rregullator,
- Zhvillimi i planeve rregullatore të bizneseve për KRU,
- Zhvillimi i raportimit operativ, financiar dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve (ROFK)
- Zhvillimi I Planit të monitorimit vjetor (PMV),
- Pjesëmarrja aktive në rrjetet ndërkombëtare të Bechmarkingut (IBNET, DANUBIS),
- Themelimi dhe funksionalizimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në 7 regjonet e Kosovës,
- Kompletimi i stafit të nevojshëm të ZRRUK, si dhe dizajnimi dhe përditësimi i faqes së internetit,
- Krijimi i raporteve me palët tjera të interesit në vend dhe jashtë vendit,
- Organizimi i një varg punëtorish për palët e interesit në sektorin e ujit,
- Përpilimi i dokumenteve të rëndësishme për funksionimin e mbrendshëm të ZRRUK,
- Publikimi i raporteve vjetore të performancës,
- Publikim i raporteve tarifore,
- Hulumtime, studime dhe analiza për çështje të ndryshme rregullatore dhe të sektorit të shërbimeve të ujit në përgjithësi.



PERFORMANCA E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT(KRU)


Sektori i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve në Kosovë, ka shënuar një progres që nga viti 2004. Ky progres është evident pothuajse në të gjithë treguesit e performacës në bazë të të cilëve Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim e monitoron dhe e vlerëson punën e kompanive të licencuara që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza në Kosovë.

Një pjesë e meritave për progresin e arritur duhet padyshim ti atribuohet kontekstit institucional të reformuar të sektorit të shërbimeve të ujësjellësit në Kosovë që është zhvilluar (konsolidimi i kompanive në baza regjionale dhe më vonë korporatizimi i tyre, si dhe instalimi i regjimit të rregullativës ekonomike), të cilat reforma kanë dhënë efekte të mëdha në vitet që kanë pasuar.

Sigurisht se një rol të rëndësishëm në arritjen e këtij progresi kanë luajtur edhe komuniteti i donatorëve me investime të konsiderueshme në mbështetjen e kompanive shërbyese, sikurse dhe menaxhmenti i këtyre kompanive.

Me gjithë progresin e arritur sektori i shërbimeve të ujësjellësit në Kosovë ka para vetit shumë sfida për të qenë në gjendje të ofrojë shërbime cilësore dhe eficiente për konsumatorët. Absolutisht nuk mund të flitet për shërbime cilësore kur të kihet parasysh fakti se shumica e kompanive të ujësjellësit nuk kanë qenë në gjendje të furnizojnë me ujë 24 orë në ditë konsumatorët e vet.

Kjo para së gjithash ka të bëjë me menaxhmentin e kompanive prej të cilëve ZRRUK pret që në të ardhmen të ekzekutojnë një menaxhim më efikas dhe më eficient dhe të arrijnë rezultate të “prekshme”, sidomos në reduktimin e humbjeve të ujit dhe në ngritjen e shkallës së arkëtimit të borxheve, që mbesin dy fushat më problematike në performancën e kompanive të ujit.



TREGUESIT E PERFORMANCËS PËR KOMPANIT RAJONALE TË UJËSJELLËSIT

Treguesi	Viti 2013
Mbulueshmëria me shërbime të ujit	82%
Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit	60 %
Prodhimi i ujit	40 (m ³ /kons/muaj)
Shitja e ujit	18 (m ³ /kons/muaj)
Prodhimi i ujit	266 l/p/d
Shitja e ujit	115 l/p/d
Uji i Pafaturuar	57 %
Komsumatorët me ujëmatës	91.7 %
Efikasiteti i stafit	7.0 ('000 kons)
Ankesat ndaj shërbimeve për 1000 konsumatorë	67 ('000 kons.)
Testet e dështuara të kualitetit të ujit	1.9 %
Shkalla e arkëtimit	71 %
Shkalla e arkëtimit për kons. Shtëpiak	62 %
Shkalla e arkëtimit për kons. Komercial-Industrial	81 %
Shkalla e arkëtimit për kons.institucional	103 %
Norma e mbulimit të punës	1.09

Tabelë: Performanca mesatare e përbashkte e 7 (shtatë)- KRU, në disa Treguesi Kyq të Përformances.

SFIDAT E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT

Sektori i shërbimeve të ujësjellesit dhe të ujërave të zeza në Kosovë, është duke u përballur me disa sfida aktuale, prej të cilave ne mundë të veqojmë disa prej tyre:

Ruajtja e qëndrueshmërisë së shërbimeve ekzistuese, efienca aktuale e faturimit dhe arkëtimit të faturave për shërbimet e ofruara nuk mundë të garantojë qëndrueshmëri afatgjate dhe të sigurtë të afarizmit të KRU. Për më tepër disa përmirësime të kufizuara të efiençes komerciale janë të pa përfillshme përballë rritjes së vazhdueshme të kostos së operimit dhe të mirëmbajtjes. Nga ana tjetër UPF gjithnjë në rritje deri në nivele të pa akceptueshme përfundimisht i sjellë këto kompani në një situatë jo të mire financiare.



Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe të shërbimeve të ujërave të zeza (kanalizimit), gjatë disa viteve të fundit në Kosovë është përmirësuar me një tempo të ngadalshme, përderisa trajtimi i ujërave të zeza është në fazën fillestare. Në këtë sektor Kosova, renditet ndërmejt vendeve të ballkanit me rezultat më të ulët në këtë aspekt.

Përmirësimi i përgjithshëm i cilësisë së shërbimit. Ofruesit e shërbimeve të ujit duhet vazhdimisht të rrisin përkushtimin për të krijuar marrëdhënje reciproke në mes cilësisë së shërbimit dhe çmimit të cilin e paguajnë konsumatorët, kjo duhet të bëhet me qëllim për të redukuar ngarkesat që konsumatorët duhet të paguajnë për mos efikasitetin e tyre. Megjithatë me përmirësimin e cilësisë së shërbimit, ne jemi të sigurt se shumica e konsumatorëve janë të gatshëm të paguajnë edhe më tej, për një vlerë shërbimin. Prandaj është shumë e rëndësishme për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e furnizimit, nivelet e furnizimit dhe afërsin ndaj konsumatorëve, karakteristikë e cila, aktualisht është e dobët në sektorin publik të furnizimit me ujë në Kosovë.

Qeverisja e mirë korporative dhe mbikqyrja efektive e afarizimit, ju mundëson kompanive të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza për të zhvilluar strategjit zhvillimore dhe për të përkthyer, këto në plane të realizueshme, zhvillimore të biznesit. Megjithatë ato duhet të jenë të afta për zbatimin e tyre dhe nën një sistem efikas të raportimit të jenë në gjendje të analizojnë për të rregulluar situatën ekonomike të kompanis në përputhje me rrethanat në çdo kohë.

Bordet e Drejtorëve duhet gjithashtu të jenë të fokusuar për të verifikuar elementet kyçe të performancës së kompanive dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin veprime korrigjuese aty ku kërkohet. Bordet e Drejtorëve duhet të jenë në nivel të përgjegjësive dhe profesionalizmit për të kryer mandatin e tyre sa më mirë.

SYNIMET STRATEGJIKE TË ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM

ZRRUK ka përcaktuar disa qëllime strategjike, të cilat do të duhej të plotësoheshin me qëllim të realizimit të vizionit, dhe misionit të saj:

- ✓ Garantimi dhe zbatimi i legjislacionit primar dhe sekondar i ZRRUK,
- ✓ Përcaktimi i tarifave korrekte për të siguruar që ofruesit e licensuar të shërbimit operojnë në mënyrë eficiente dhe financiarisht të vetqëndrueshëm,
- ✓ Sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm të stafit të ZRRUK dhe KRU që të jenë në gjendje të përvetësojnë tërësisht metodologjinë e re të përcaktimit të tarifave dhe monitorimit të performancës së KRU si dhe ngritja e kapaciteteve në ZRRUK për monitorimin e përmbushjes së standardeve të shërbimit,
- ✓ Mbështetja e siguruar ofruesve të licensuar të shërbimeve në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara konsumatorëve në nivelin që është përcaktuar me rregullat e ZRRUK, që në të njëjtën kohë kënaq edhe pritjet e konsumatorëve,
- ✓ Mbështetja e siguruar ofruesve të licensuar të shërbimeve në rritjen e shkallës së mbulueshmërisë me shërbime në pajtim me objektivat strategjike të Pushtetit Qendror dhe Lokal, si dhe përfshirjen e sistemeve komunale të furnizimit me ujë në kuadër të KRU,
- ✓ Promovimi në një nivel më të lartë i interesave të konsumatorëve, përmes adresimit të çështjeve, të pa zgjidhura në mes të konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve, në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve,
- ✓ Ngritja edhe më tutje e profilit të ZRRUK, përmes informimit me kohë i të gjitha palëve të interesit, përfshirë edhe konsumatorët, për proceset rregullatore dhe vendimet e ZRRUK,
- ✓ Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik në Kosovë dhe Evropë, etj.

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Adresa:Rr.Ferat Dragaj,, Nr. 68, Prishtinë,10000

Kosovë

Tel+ 381 38249165 ext.101/113

Fax:+381 38 249 168 129